

**Plani për menaxhim social dhe Rrethinor për nënprojektin:
'Rindërtim, renovim dhe zgjerim i Vila Vangelina në kodrën e
gjelbër të Katlanovës në afërsi të Shkupit, Komuna e
Petrovecit'**



Përmbajtja:

1.Përshkrimi i proektit.....	4
2. Kuadri ligjor.....	13
3. Të dhëna elementare/ Përshkrimi i lokacionit.....	16
4. Pasoja ndaj rrethinës dhe pasoja Sociale.....	27
5. Masat për Zbutje.....	33
6. Plan për Menaxhim Social dhe Rrethinor.....	36

Hyrje

Projekti konkurues regional dhe lokal (LCRP) paraqet një projekt për investim i cili zgjat katër vite, i mbështetur nga Unioni Europian duke përdorur fonde nga IPA II, i rezervuar për konkurim dhe inovacion në Maqedoni. LCRP do të menaxhohet si Fond Hibrid i Besimit dhe përbëhet nga tre elemente, i zbatuar nga Banka Botërore dhe nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë. Projekti do të sigurojë fonde për investime dhe kapacitet ndërtues që të mbështes rritjen e sektorit, do të investohet në destinacione dhe në prosperimin e destinacioneve specifike. Në nivelet regjinale dhe lokale, Projekti do të mbështesë destinacione të caktuara turistike në vend nëpërmjet kombinimeve të ndihmesave teknike për përmirësimin e menaxhimit të destinacioneve, do të investon në infrastrukturë, në koneksione dhe në inovime. Investimet do të bëhen sipas shemës së granteve për turizmin regjional për palët e interesuara, siç janë komunitat, institucionet, organizatat joqeveritare dhe sektori privat.

Investimet do të jenë në linjë gjatë gjithë kohës me Kuadrin e menaxhimit social dhe rrethor (ESMF), i cili është i përgaditur për Projektin për konkurim regional dhe lokal.

Ky Plan për menaxhim social dhe rrethor (ESMP është i përgaditur për aktivitete që janë bërë nën nënprojektin 'Renovim, rindërtim dhe zgjerrim i Villa Vangelina në kodrën e gjelbër të Katlanovës'.

ESMP prezanton dokumentin rrethor me kujdesin e duhur i përbërë nga përshkrimi i projektit, detalet teknike, sa është i gjërrësishëm, vendndodhja dhe lokacioni, në bazë të së cilave vlerësohen pasojat rrethore dhe sociale dhe me këtë bëhet shmangja e masave zbutëse kundrejt tyre. Implementimi i masave zbutëse të drejtuara kah pasojat e identifikuar rrethore dhe sociale të definuara në ESMP janë obligative.

Ky nënprojekt do të ofrojë mundësi për përforsimin e kontakteve turistike dhe për biznes me agjencionet turistike të Republikës së Maqedonisë, dhe gjithashtu do të zmadhojë ofertat turistike për agjencionet egzistuese turistike dhe për kapacitetet e akomodimeve të hoteleve (sipas gjasave se turistët do të jenë më shumë të interesuar që ta vizitojnë këtë lokalitet), si dhe mundësitë për vetë-punësim të banorëve të rajonit lokal.

1. Përshkrimi i projektit

Qëllimi kryesor i këtij nënprojekti është përmirësimi i përvojës së përgjithshme që vizituesit kanë ndaj vendeve rurale të rrethinës së Shkupit.

Qëllimet specifike të nënprojektit janë:

- Të përmirësohet funksionaliteti dhe kapaciteti i akomodimit të Villa Vangelinës
- Të tërhiqen turistët dhe vizituesit të cilët do të vizitojnë dhe do të hulumtojnë lokalitetin e Katlanovës. Rrethina më e gjërë e këtij lokaliteti posedon florë dhe faunë të shumëllojshme.
- Që Villa Vangelina të jetë e vendosur në hartën turistike të Republikës së Maqedonisë
- Të mundësohen aktivitete të ndryshme për hulumtimin e këtij vendi

Përshkrimi i situatës së tashme dhe objekteve egzistuese të villa Vangelina

Situata momentale në villa Vangelina është kjo:

- 2 njëkatëshe
- Njëkatëshi 1, me 5 apartamente, një dhomë për hekurrosje dhe terracë- fotografia 1
- Njëkatëshi 2, me dhomë të ditës, terrac; dhe 1 apartament (2 dhoma të gjumit), apartamentet në dy njëkatëshet kanë një kapacitet total për akomodimin e 22 personave;
- Reastaurant me gjërësi prej 70m² (kapacitet për 30 vizitorë), e cila gjithashtu posedon terrace prej 975m²), me një kapacitet total për 150-160 persona- fotografia 2
- Qendër për edukim/ organizim i ndodhive/ sallë konferencash (70m²), me kapacitet për 60 persona;
- Pishinë për rekreim (12mx6m)-fotografia 4, me rrethinë për ulje rreth pishinës me gjërësi prej 400m², pjesë sanitare dhe teknike 912x5m²) e pajisur me 5 dhoma, nga të cilat 4 janë toaleta dhe një për veshje)-fotografia 5. Sa i përket pjesës teknike kemi pompë të ujit dhe tjera pajisje mekanike dhe elektrike;

- Vend i paraparë për shesh të lodërave të fëmijëve me sipërfaqe prej 300m² (i pastruar nga barrërat dhe vegjetimi).

-



- Fotografia 1-Njëkatëshi 1



Fotografia 2 -Restauranti



- **Fotografia 3 –Hapësira për parkim veturash**



- **Fotografia 4- Pishina**



- **Fotografia 5** Objekt i parashikuar për pjesën teknike dhe dhomat e pishinës



- **Fotografia 6** Lokacioni për instalimin e derës së hymjes



- 7** Lokacion i parashikuar për instalimin e derës së hyrjes së hapësirës për parkim

Qëllimet kryesore dhe specifike do të arrihen me aktivitetet vijuese të nënproektit:

1. Rregullimi dhe rekonstruimi i mbrendshëm i 6 apartamenteve. Këto apartamente do të jenë tërësisht të mbaruara dhe të rregulluara (çati e instaluar, fasadë, dysheme, enterieri dhe eksterieri, instalimi elektrik, punët hidraulike,kanalizimi dhe kullimi, dritat);
2. Pajisja e apartamenteve në stilin dhe ambientin e vendit që e rrethon si dhe përmbajtje e ofruar e të gjithë objektit, duke i ofruar të gjitha kushtet e volitshme për një vizitë të rehatshme të turistëve (instalimi i tullave, dysheme të përpunuara nga druri, dyer të hyrjes, pajisje të sanitarisë, mobilje, kondicionim i ajrit, TV);
3. Renovim i sallës së konferencave-rregullime dhe punë përfundimtare e papafingos dhe gjetjes së mjeteve-(instalimi i 13 dritareve të reja, një derë të mbrendshme, 40 karrike të drurit, 10 tavolina të drurit);
4. Pajisje me dhe instalim i 4 paneleve solare- për rritje të efikasitetit energjetik dhe që të kursehet energji;
5. Zhvillim dhe instalim i një web-platforme, me qëllim që të sigurohet qasja e lehtë deri tek informacionet në lidhje me akomodimin, aktivitetet dhe përmbajtjet tjera të objektit;
6. Blerja e pajisjeve për restaurant të jashtëm: 80 karrike të drurit; 26 tryeza për ngrënie, 15 tavolina të plastikës, 120 karrike të plastikës, etj);
7. Blerja dhe instalimi i kuzhinës moderne për nevojat e restaurantit, me ndarëse të frigoriferit për ngrierje, frigorifer dhe pjesë të ngrierjes në formë vertikale, frigorifer për pemë dhe perime, 10 komora për ftohje që gjenden nën tavolinat e punës me përmasa 70-80 cm, 2 friteza, 22 vitore të instaluara, 4 vitore, 1 furrë, 1 makinë për larje të rrobave, 1 makinë për larje të enëve dhe tavolina pune (të gjata 12m);
8. Blerje dhe instalim i pajisjeve sanitare për banjo dhe rreth pishinës, siç janë: dushet, legenat për larje dhe rubinetet e toaletëve;
9. Rregullim hortikulturor i vendit me: drunj me gjelbërim të përhershëm, bar, lule, sistem për irrigacion;

10. Rregullimi i vendit egzistues për parkim veturash- i mbuluar me zhavorr dhe instalim i dritave- sigurimi hapësirës për parkim për 40 vetura, 1 autobus dhe 1 furgon;
11. Rregullimi i hapësirës për lojëra të fëmijëve me pajisje për aktivitete zbavitëse për fëmijë, blerja e dy luhatëseve, 2 kolovitëse, vend me rrërë dhe rrotulluese;
12. Vendosja e gardhit rreth kompleksit- 90 m gardh të drurit me 110 cm gjatësi dhe 280m gardh i galvanizuar me ngjyrë 125x50cm;
13. Instalimi i 3 dyerve rrëshqitëse: derë metalike me dy pjesë me motor elektrik (5m x 160 cm), derë hyrëse me dy pjesë të metalit dhe drurit (4,5m x160 cm)- Fotografia 6, dhe derë për hyrje deri te hapësira e parkimit , me dy pjesë metal me motor elektrik (7m x 160cm)- Fotografia 7.

Plani urbanistik për apartamentet, restaurantin dhe kuzhinën janë të prezantuara në Aneks.

Pajisje me ujë

Uji sanitarik për nevojat e të punësuarve, vizitorëve të vilës si dhe për mbrojtje nga zjarri janë të siguruar nga rrjeti lokal për pajisje të ujit nga fshati I Blacës, duke u konsideruar si rrethinë e këtij fshati. Matëset e ujit dhe pajisjet hidraulike janë aty, parashikohen vetëm aktivitete për rikonstruim dhe instalim të mëtutjeshëm.

Menaxhimi i ujërave të zeza

Të gjitha ujërat e zeza nga toaletet do të mbledhen në jamën septike nga betoni e cila është rezistente ndaj rrjedhjeve (5mx5mx3m=75m³)

Infrastruktura elektroteknike

Kemi një strukturë egzistuese elektroteknike, prandaj objektet do të jenë të lidhura me rrjetin egzistues energjetik.

Më poshtë kemi një përshkrim të aktiviteteve të planifikuara ndër këtë nënprojekt.

Njëkatëshi 1

Njëkatëshi 1 është i ndërtuar si objekt përdhese. Kati përdhese posedon këto përmbajtje vijuese funksionale: dhomë e ditës, kuzhinë me dhomë të ngrënies, dy dhoma të gjumit me banjo dushi, toalete dhe terrace. Dyshemeja do të jetë nga parketi dhe pllakat keramike. Tavani i papafingos do të jetë i përpunuar si tavan i ulur nga plastdërrasat. Të gjitha hapjet janë të rregulluara me brava PVC të cilat janë të lyera me thermopan të rrafshuar me qelq 4+16+4mm. Të gjitha dhomat janë të ndriçuara në mënyrë natyrale nepërmjet dyerve dhe dritareve.

Sipërfaqja e tërësishme e njëkatëshes është kështu si vijon:

01	Aparatment1 1	Dysheme-pllaka keramike	22,49 m ²
01a	Banjo	Dysheme-pllaka keramike	3,42 m ²
02	Apartament 2	Dysheme-pllaka keramike	22,51 m ²
02a	Banjo	Dysheme-pllaka keramike	3,42 m ²
03	Apartament 2	Dysheme-pllaka keramike	17,10 m ²
03a	Banjo	Dysheme-pllaka keramike	3,42 m ²
04	Aparatment 3	Dysheme-pllaka keramike	12,44 m ²
05	Banjo	Dysheme-pllaka keramike	14,07 m ²
06	Dhoma teknike	Dysheme-pllaka keramike	22,51 m ²
06a	Roja/Sigurimi	Dysheme-pllaka keramike	3,42 m ²

07	Apartament 4	Dysheme-pllaka keramike	22,13 m ²
07 a	Banjo	Dysheme-pllaka keramike	3,42 m ²
Sipërfaqja e tërrësishme neto			150,35 m ²
01 t	Terracë	Dysheme-pllaka keramike	7,92 m ²
02 t	Terracë	Dysheme-pllaka keramike	6,93 m ²
03 t	Terracë	Dysheme-pllaka keramike	9,89 m ²
06 t	Terracë	Dysheme-pllaka keramike	7,31 m ²
07 t	Terracë	Dysheme-pllaka keramike	7,46 m ²
Sipërfaqja e tërrësishme bruto			238,50 m²

Njëkatëshi 2

Njëkatëshi 2 është i ndërtuar si objekt përdhës. Në katin përdhës kemi këto përmbajtje funksionale : dhomë të ditës, kuzhinë me dhomë të ngrënies, dy dhoma të gjumit me banjo dhe dush, dhomë ndihmëse, toalete sanitare dhe terracë. Dyshemeja do të ndërtohet nga parketi dhe pllakat e keramikës. Tavani i papafingos do të ndërtohet si tavan i ulur nga plastdërrasat. Të gjitha hapjet janë të mbyllura me brava PVC të cilat janë të lyera me thermopan të rrafshuar me qelq 4+16+4m. Të gjitha dhomat janë të ndriçuara në mënyrë të natyrshme nëpërmjet dyerve dhe dritareve.

Sipërfaqja e tërrësishme e këtij njëkatëshi është si vijon:

01	Dhoma e ditës	Dysheme- parket	28,40 m ²
02	Kuzhina me dhomën e ngrënies	Dysheme- pllaka keramike	9,30 m ²
03	Toalet	Dysheme- pllaka keramike	2,43 m ²
04	Banjo	Dysheme- pllaka keramike	3,48 m ²
05	Banjo	Dysheme- pllaka keramike	3,48 m ²
06	Dhoma e gjumit	Dysheme- parket	15,50 m ²
8	Dhoma e gjumit	Dysheme- parket	15,50 m ²
Sipërfaqja e tërrësishme neto			78,90 m ²
08	Terracë	Dysheme- pllaka keramikës të	6,40 m ²
09	Terracë	Dysheme- pllaka keramikës të	21,00 m ²
Sipërfaqja e tërrësishme bruto			122,76 m²

Mjeshtria e ndërtimit, betonit dhe masonerisë do të jetë e kryer në pajtim me Dizajnin i Detajeve Kryesore, dhe në pajtim me rregullat teknike dhe normat që janë në përpikshmëri me këto lloje të punës. Dizajni parasheh punët vijuese masonerike:

Njëkatëshi 1

Murri i fasadës

-Tullat për fasadë 12 cm (pjesërisht të përfunduara)

-Polistirol poroz 5 cm

-PE fletë metalike

-Blok thermal 20 cm(I përfunduar)

-LLaç 2cm

Murri i mbrendshëm ndarës

-LLaç 2 cm(I përfunduar)

-Tulla poroze12 cm(i përfunduar)

-LLaç 2cm

Murri i mbrendshëm ndarës

-Tulla poroze 25 cm(i përfunduar)

-LLaç 2 cm

Njëkatëshi 2

Murri i fasadës

-Tullë për fasadë 12 cm (pjesërisht e përfunduar)

-Polistirol poroz 5 cm

-PE fletë metalike

-Blok thermal 20 cm (i përfunduar)

-LLaç 2 cm (i përfunduar)

Murri i mbrendshëm ndarës

-LLaç 2 cm

- Tulla poroze 12 cm (i përfunduar)

-LLaç 2 cm

Dyshemetë:

Dyshemetë janë të trajtuara supas tipit dhe qëllimit të dhomave dhe ato do të jenë të mbuluara me pllaka keramike. Papafingoja do të jetë e lëmuar dhe e lyer me polikolor.

Zdrukthtaria

Dritaret dhe dyert e jashtme të parashikuara janë PVC i mbuluar me qelq thermopan.

Derratat e mbrendshme do të jenë të drunjëta.

Me zgjidhjen e proektit (Dizajn i Detajuar), janë të parapara edhe punët e izolimit, ose mbrojtja termale e objektit. Mbrojtja termale e objekteve arrihet me mburojën termale të objektit dhe me zgjedhjen e duhur të fasadës, si dhe me zgjedhjen e dyerve, dritareve dhe mburojën e çatisë.

Restauranti

Restauranti me Dizajn kryesor është i paraparë si (P + 1) kat përdhes dhe si kat (GF+ F1) Në katin përdhes kemi këto struktura: restaurant për 30 mysafirë (me terracë 150-160 mysafirë), kuzhinë dhe toalete. Kati përdhes është i lidhur me terracë dhe kopsht.

Në katin e pare kemi një terracë e cila është e ndërlidhur me katin përdhes me anë të shkallëve.

Në kuptimin ndërtimor, objekti është i ndërtuar si konstruksion i përforcuar me beton skeletal, me shtylla të cilat mbajnë peshën dhe pllaka të betonit si konstruksion ndërbrinjësor. Tavani i papafingos duhet të përpunohet si tavan i ulur me dërrasa. Të gjitha hapjet janë të mbuluara me brava PVC, të cilat janë të lyera me qelq të rrafshët thermopan me sasi të vogël të silikonit 4+16+4mm.

Të gjitha dhomat janë të ndriçuara në mënyrë natyrale nëpërmjet dritareve dhe dyerve. Të gjitha instalimet do të jenë të instaluara në këtë objekt, siç janë : hidraulika, kanalizimi, elektriciteti. Ngrohja do të bëhet me anë të inverterëve.

Sipërfaqja e tërërsishme e restaurantit është siç vijon:

Kati përdhes			
01	Restauranti	Dyshemeja- pllaka keramike	86,80 m ²
02	Kuzhina	Dysheme- pllaka keramike	14,80 m ²
03	Dhomë ndihmëse	Dysheme- pllaka keramike	3,97 m ²
04	Legen për larje	Dysheme- pllaka keramike	3,68 m ²
03	Toalet	Dysheme- pllaka keramike	1,50 m ²
03a	Toalet	Dysheme- pllaka keramike	1,62 m ²
Sipërfaqja e tërrësishme neto			133,47 m²
Kati i parë			
01	Terracë	Dysheme- pllaka keramike	49,37 m ²
02	Shkallët	Dysheme- pllaka keramike	6,43 m ²
Sipërfaqja e tërrësishme bruto			64,40 m²

Realizimi i aktiviteteve të këtij nënproekti edhe më tej do ta zmadhon tendencën e këtij vendi që të zhvillon turizmin rural në këtë lokalitet. Pritjet e përgjithshme në lidhje me realizimin e këtij nënproekti janë ‘aktraktiviteti i zmadhuar për vizitë të rrethinave rurale, rivendosja e popullatës nga qytetet nëpër fshatra, dhe kënaqësi e zmadhuar ndaj konsumimit të ushqimit me kualitet të lartë nga kuzhina maqedonase si dhe prodhimet ushqimore Maqedonase’.

Rezultatet e pritura nga ky nënproekt janë:

a) Apartamente të rinovuara, të riparuar dhe të plotësuara me kapacitet të akomodimit nga 22 vizitorë, 5 apartamente me shtrate kualitative dhe të rrehatshme, me elemente tradicionale përsa i përket dizajnit, në stilin dhe shpirtin e rrethinës që e rrethon.

b) Kuzhinë plotësisht e pajisur dhe restaurant me kapacitet për servimin e 150-160 vizitorëve me ushqim kualitativ tradicional Maqedonas dhe sallë konferencash në stil modern me kapacitet për akomodimin e 60 personave.

c) Aftësi të larta për pregaditjen e ushqimit tradicional Maqedonas dhe përvojë unike dhe autentike të kuzhinës në rajon është rezultati i tretë që pritet të arrihet, dhe i cili do të arrihet nëpërmjet trajnimeve për përmirësimin e aftësive për pregaditje të ushqimit tradicional Maqedonas, si dhe aftësi të prezantimit dhe të degustimit, orë mësimore për pregaditje të ushqimit, aktivitete të jashtme për degustimin e ushqimit dhe verës etj.

Realizimi i këtij projekti do të ketë një ndikim pozitiv mbi destinacionin (Komuna e Petrovecit, fshati i Katlanovës dhe rrethina e tij), dhe do të ofron mundësi të shkëlqyeshme për rritjen e tërheqjes ndaj bukurisë natyrore të këtij destinacioni. Harta turistike do të pasurohet edhe me një lokalitet, duke ofruar shumëllojshmëri të bukurive natyrore të këtij destinacioni.

Ofertat turistike për këtë destinacion do të zmadhohen me anë të realizimit të këtij nënprojekti, dhe do të ketë ndikim gjithashtu në zhvillimin ekonomik të shtetit. Duke arritur qëllimin elementar do të arrihet edhe qëllimi i LRCP, që është 'të rritet kontributi i turizmit ndaj zhvillimit ekonomik lokal, si dhe të përmirësohet kapaciteti i inkrurajimit që të zhvillohet turizmi, dhe të lehtësohet menaxhimi i destinacioneve.'

2. Kuadri ligjor

Procedura për Vlerësimin Nacional të Ndikimit ndaj Rrethinës për zhvillimin e projektit

Procedura për Vlerësimin Nacional të Ndikimit ndaj Rrethinës jetësore, është e paraqitur në Ligjin e ('G Rrethinës jetësore 'Gazeta Zyrtare Nr.'53/05, 81/05 24/07, 159/08 dhe 83/09; 124/10, 51/11, 123/12, 93/13, 163/13, 42/14, 129/15 dhe 39/16 (Kapitulli XI/Artikujt 76-94) ku kërkesat e Direktivave të EU mbi EIA (Direktiva 85/337/EEC, e ndryshuar nga Direktivat 97/11/EC, 2003/31/EC) kanë qenë të transpozuar. Procedura fillon kur Investuesi (Përfituesi i Projektit), i cili ka për qëllim të implementon një projekt, dorëzon një Letër të qëllimit në formë të shkruar dhe elektronike deri te Ministria e Rrethinës jetësore dhe Planifikimit Fizik (MoEPP-Administrata për Rrethinë jetësore) e cila paraqet autoritet kryesor për të gjithë procedurën. Administrata për Rrethinë jetësore është e obliguar të dorëzon raport për kërkesën specifike, pavarësisht nëse duhet ose nuk duhet të zhvillohet me SEA, EIA ose Elaborat për mbrojtje të rrethinës jetësore. Procedura e ekzaminimit paraqet një fazë gjatë së cilës MoEPP vendos nëse SEA, EIA ose Elaborati duhet kryer ose jo për një projekt të caktuar. Për zhvillimin e


proekteve të cilat nuk e kanë vendin në listën e projekteve për të cilat duhet të zbatohet procedura EIA (Proekte të kategorive të vogla), atëherë ka kërkesë për pregaditjen e një 'Elaborati për mbrojtje të Rrethinës jetësore - Raport për vlerësimin e ndikimit ndaj rrethinës jetësore'(me rëndësi për projektet të Kategorisë B, nën Procedurën e vlerësimit të rrethinës jetësore WB OP 4.0.1).

Procedura nacionale për vlerësim të rrethinës jetësore të projekteve të kategorive të vogla

Gjatë Procedurës nacionale EIA në fazën e egzaminimit, nëse është marrë vendimi nga Ministria e Rrethinës jetësore dhe Planifikimit fizik që nuk ka nevojë që të zbatohet procedura EIA, investuesi duhet të fillon me procedurë për zhvillimin e Elaboratit për mbrojtje të rrethinës jetësore. Kjo procedurë është e patjetërsueshme për projekte të kategorive të vogla të cilat mund të shkaktojnë ndikime të vogla negative dhe afatshkurta ndaj mjedisit jetësor kur Ministria e Rrethinës jetësore dhe Planifikim fizik me deklaratën e lartpërmendur kanë deklaruar se egziston nevoja për pregaditjen e Elaboratit në pajtim me rregulloret e cituara në vijim (psh. Rindërtimi ose ndërtimi i rrugëve lokale, udhëve, ndërtimi i sistemeve lokale për furnizim me ujë të pijshëm, sisteme të kanalizimit dhe WWTP të kategorive të vogla- më pak se 10000p.e.etj). kemi dy Dekrete me të cilat qartësohet se për cilat projekte duhet të pregaditet Elaborati:

- a) Dekret për listen e projekteve për të cilat duhet të pregaditet Elaborati për mbrojtje të rrethinës jetësore nga ana e investuesit, dhe ky Elaborat duhet miratuar nga Ministria e Rrethinës jetësore dhe e planifikimit fizik ('Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë 'Nr.36/12);
- b) Dekret për listen e projekteve për të cilat duhet të pregaditet Elaborati për mbrojtje të rrethinës jetësore nga ana e investuesit, dhe ky Elaborat duhet të miratohet nga Kryetari i Komunës ose Kryetari i Qytetit të Shkupit ('Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë'Nr.32/12). Përmbajtja e Elaboratit për mbrojtje të rrethinës jetësorer-raporti EIA, duhet të jetë në pajtueshmëri me Rregulloren për Raport EIA, forma, përmbajtja dhe procedura për pranimin e raportit EIA (Gazea Zyrtare e RM NR.123/12). Raporti- Elaborati EIA përmban karakteristikat kryesore të aktiviteteve të projektit, ndikimet kryesore pozitive dhe negative që janë të identifikuara ndaj mjedisit jetësor, duke pasur parasysh të dhënat rrethimore specifike të vendit. Programi për Mbrojtje të Rrethinës Jetësore shumë i thjeshtëzuar përfshin masa të ndryshme të cilat do të parandalojnë, do të zbusin ose do të kompenzojnë ndikimin e pafavorshëm ndaj të gjitha elementeve të mjedisit jetësor, të cilat duhet të zhvillohen duke u bazuar në legjislacionin nacional për rrethinë jetësore dhe praktikës së mirë internacionale. Nuk propozohet asnjë gjykim publik gjatë pregaditjes dhe pranimit të Elaboratit-Raportit EIA (sipas legjislacionit nacional). Në fotografinë 8 është e prezantuar shema e thjeshtëzuar

e procedurës së Raportit- Elaboratit, si dhe autoriteti kompetent për pranimin e Raportit/Elaboratit e EIA.



Sipas kërkesave të parashtruara nga legjislacioni nacional për realizimin e aktiviteteve të propozuara në suaza të nënproektit ‘Renovim, rindërtim dhe zgjërimit i Villa Vangelinës në kodrën e gjelbër të Katlanovës’, egziston nevoja që të pregaditet Elaborat për Mbrojtje të Rrethinës jetësore. Elaborati për Mbrojtjen e Rrethinës Jetësore është i pregaditur dhe Vendimi për miratimin e tij lëshohet nga Komuna e Petrovecit dhe është i ngjitur në Aneks.

Konsultime publike për Planin për menaxhim social dhe të Rrethinës jetësore.

Plani i pregaditur për Menaxhim Social dhe i Rrethinës jetësore (ESMP) për këtë projekt do të jetë pjesë e dokumentacionit për ofertë dhe Kontratë me Kontraktuesin (me faturat e kuantiteteve) , i cili do të jetë i obliguar për implementimin e masave të parashikuara sipas Planit për Monitorim dhe Zbutje. Implementimi i ESMP është obligativ për Kontraktuesin. Inxhinieri për mbikqyrje ka për obligim të monitoron edhe të vlerëson implementimin e masave të propozuara në suaza të Planit për Monitorim dhe Zbutje, dhe ka për detyrë të informon investuesin dhe LRCP Zyrën e projektit/ Komuna e Petrovecit.

Kontraktuesi/Global DVD DOOEI-Kumanovë do të raportojë mbi gjendjen e rrethinës jetësore dhe për aplikimin e masave për zbutje dhe monitorim të parashikuara në këtë ESMP, në procesin e raportimeve të rregullta të këtij nënprojekti për çdo tre muaj (përveçse nëse caktohet ndryshe nga eksperti i rrethinës jetësore, i miratuar nga Specialisti i Rrethinës jetësore nga WB) deri tek eksperti për rrethinë jetësore.

Sipas LRCP Strukturës për menaxhim social dhe Rrethinor (ESMF), ESMP duhet të kalon një konsultim publik para se më në fund të miratohet nën-granti. Në momentin që verzioni skicë ESMP miratohet nga Njësia për Implementim të Proektit (PIU),eksperti i rrethinës jetësore dhe WB Specialisti për rrethinë jetësore, do të botohet në web faqen e LRCP PIU dhe/ose në Kabinetin e Zëvendës Kryeministrit për Punë Ekonomike, në Agjencionin për promovim dhe mbështetje të turizmit dhe në webfaqen e Komunës në fjalë (Komuna e Petrovecit), ku do të mbesë në qasje për publikun për së paku 14 ditë. Në qasje do të kemi një kopje të printuar në LRCP PIU/ Kabinetin e Zëvendës Kryeministrit të Qeverisë të Republikës së Maqedonisë për Punë Ekonomike (CDPMEA) dhe në Komunën e Petrovecit. Së bashku me ESMP do të kemi thirrje për komente dhe pjesëmarrje në mbledhje me konsultime me publikun (me kohë dhe vendndodhje). Mbledhja për konsultim me publikun do të mbahet në komunën në fjalë, në fund të periudhës së konsultimeve. Në mënyrë proaktive, Aplikuesi (Global DVD DOOEI, Kumanovë, në bashkëpunim me Komunën e Petrovecit), do ti informon dhe do ti fton palët kryesore të interesuara në këtë projekt, duke përfshirë edhe organizatat joqeveritare të vendit, komunitat dhe bashkitë të interesuara dhe kjo do të bëhet në mënyrë direkte dhe të përshtatshme. Komentet e dhëna do të përfshihen në Raportin e Dëgjimit Publik, e cila do të jetë pjesë e verzionit final të ESMP. Në këtë mënyrë, të gjitha komentet nga publiku do të jenë në dispozicion për aplikantët, kurse ato do ti marrin parasysh të gjitha komentet e rëndësishme dhe do ti mbulojnë përgjigjet dhe të dhënat në ESMP-në përfundimtare.

ESMP duhet të jetë e përfunduar në gjuhë angleze, maqedonase dhe shqipe. Implementimi i Planit për Menaxhim Social dhe të Rrethinës jetësore do të mundëson që të ndërmerren me

kohë masat e propozuara dhe të jepet kontribut për realizimin e aktiviteteve të projektit pa pasur ndonjë ndikim serioz ndaj rrethinës jetësore.

3.Të dhëna elementare/Përshkrimi i lokacionit

3.1. Kuadri Institucional dhe kapaciteti përfitues

Aktivitetet e lidhura me implementimin e nënprojektit 'Rinovim, rindërtim dhe zgjerim i Villa Vangelina' do të bëhet në territorin e Komunës së Petrovecit nga punëtorët e kompanisë Global Center DVD LTD eksport-import, Kumanovë.

Kompania për prodhim, ndërtim, tregëti, shërbime dhe komunikacion Global Center DVD LTD eksport-import, Kumanovë, është e themeluar në Kumanovë në vitin 1989, ndër emrin SKOPSKO DOOEL, Kumanovë. Aktiviteti kryesor i kësaj kompanie është shitja me shumicë e pijeve dhe prodhimeve ushqimore për rajonet e Kumanovës, Probishtipit, Kratovës dhe Kriva Palankës. Në vitet e para të themelimit kemi gjithsej 45 të punësuar. Në vitin 2001, kompania ishte e reregjistruar për shkak të hyrjes në segmentit e ndërtimtarisë. Kjo kompani ka arritur suksese të konsiderueshme, dhe qendra e distribumit disa herë ka fituat çmime si qendër më e mirë dhe më e suksesshme e distribuimit në të gjithë shtetin.

Që nga viti 2008, SKOPSKO DD DOOEL i ka zgjëruar aktivitetet e saj në prodhimet e hershme kopshtare nëpër shtëpi të gjelbërta (serra) në Mlado Nagoriçane të Kumanovës. Kompania ka filluar me realizimin e ciklit të madh të investimeve në rindërtimin e serrave në një zonë prej 1200,000m². Është bërë edhe rinovim i instalimit elektrik dhe sistemeve të irigacionit, me ndihmën e së cilës me sukses janë prodhuar kultura të hershme kopshtare nga viti 2008 deri 2017.

Pas skadimit të kontratës për përfaqësim regional me kompaninë PIVARA, Skopje, SKOPSKO DD DOOEL është riemërtuar si GLOBAL CENTER DVD DOOEL, Kumanovë. Në suaza të strategjisë zhvillimore të GLOBAL CENTER DVD, është përfshirë edhe idea për turizmin rural familjar, prandaj, nga viti 2011, kjo kompani ka investuar fonde të mëdha në ngritjen e objektit 'Vila Vangelina' dhe ka krijuar strategji për zhvillimin e destinacionit për mikro-turizëm në fshatin Bllacë, në komunën e Petrovecit.

Fakti që GLOBAL CENTER DVD LTD, Kumanovë, ka punuar me sukses për më shumë se 30 vite në shumë degë, paraqet dëshmi të mjaftueshme se ka një përvojë të madhe të sipërmarrësisë, veprim të suksesshëm në biznes dhe rëndësi për realizimin dhe rritjen e turizmin rural familjar. Pas nisjes së projektit 'Villa Vangelina', ekipi i cili do të vazhdon me punën është i gatshëm ta mirëmban funksionalitetin e këtij destinacioni turistik dhe të arrijë rezultate të mira në të ardhmen.

Në pajtueshmëri me legjislacionin nacional të Republikës së Maqedonisë për realizimin e këtij nënproekti, GLOBAL CENTER DVD LTD, Kumanovë ka fituar Vendimin për aprovimin e Elaboratit për Mbrojta të Rrethinës jetësore për aktivitetet e parapara për rinovim, rindërtim dhe zgjerim të 'Vila Vangelina', në lokalitetin kodra e gjelbër e Katlanovës.

Duke marrë parasysh aktivitetet e parapara të proektit, është fituar leje për ndërtim dhe për aktivitetet e rinovimit, rindërtimit dhe zgjerimit të 'Vila Vangelina' në pajtim me Ligjin për ndërtim ('Gazeta zyrtare e R. Së Maqedonisë Nr.130/09 dhe amandamentet e tij), si dhe miratim për instalimin e mjeteve për sheshin e lodrave të fëmijëve. Të gjitha aktivitetet infrastrukturore do të bëhen në pajtim me kërkesat teknike të proektit të deklaruar në dokumentacionin e pregaditur prej më parë, të cilën duhet ta kontrollojnë dhe ta implementojnë Kontraktuesi.

3.2.Vetitë gjeografike, reljeji dhe gjeologjia

Komuna e Petrovecit gjendet në pjesën juglindore të Kodrës së Shkupit dhe në mënyrë të drejtëpërsëdrejtë merr pjesë në rajonin më të poshtëm mjedis lumit Vardar dhe lumit Pčinja. Në perëndim, në anën e djathtë të lumit Pčinja, i cili rrjedh në mjedis të territorit të komunës së Petrovecit, kemi nivelin e Skopsko Pole, derisa në anën e djathtë të lumit, pranë rrafshit aluvial kah rajoni Otovica, gjendet një tokë kodrinore e cila njihet si Katlanovo Brdo.



Fotografia 9 Vendndodhja e Komunës së Petrovecit

Territori i komunës së Petrovecit mbulon një vend prej 222km², dhe merr pjesë në komnat me madhësi të mesme të Republikës së Maqedonisë.

Komuna e Petrovecit karakterizohet me pozitë të favorshme gjeografike:

-Largësia prej 17 km nga kryeqyteti i Maqedonisë (qyteti i Shkupit);

-Largësia prej 5 km nga aeroporti 'Petroves'-Shkup;

- Shtrihet përgjatë autostradës E-75, Shkup- Gjevgjeli- Selanik;

-Shtrihet përgjatë rrugës regjionale R-103, Shkup-Veles;


-Largësia prej 10 km nga autostrada Shkup-Beograd.

Gjeologjia

Karakteristikat kryesore të kësaj komune janë sedimentet aluviale-deluviale dhe depozitat të argjilit dhe të gurit. Kemi masa tu gurrëve që janë të lidhura dobët dhe karakterizohen me tipare të ulëta gjeologjike-inxhinerike.

1.3 Karakterisrika hidrologjike

Vendndodhja e komunës së Petrovecit i takon rajonit për Menaxhim të Ujit (WMA) në Shkup, e cila mbulon legenin lokal të lumit Vradar nga profili ujqor Radusha, deri te burimi i lumit Pçinja, pa turmën e lumit Treska dhe në të djathtë me degën e Markova dhe Kadina Reka, dhe në të majtë me degët e Lepencit dhe Seravës. Burimet e ujit për këtë komunë janë lumi Vardar dhe Pçinja.



Fotografia 10 Harta hidrografike e Republikës së Maqedonisë

Lumi Vardar është lumi më i gjatë dhe më madhor në Republikën e Maqedonisë. Buron nga burimi në fshatin Vrutok i cili gjindet në pjesën jugperëndimore të Luginës së Vrutokut në ultësinë e Malit Sharr në lartësi prej 683 m. Prej shtetit tonë përfundon në Gjevgjeli në lartësi prej 43 m, dhe pastaj rrjedh nëpërmes Greqisë dhe derdhet në Detin Egje. Gjatësia e plotë e lumit është 388 km, nga të cilat shtetit tonë i takojnë 301km. Nga burimi deri te grykëderdhja mbulon rrjedhë ujore prej 28.588 km², nga të cilat në Republikën e Maqedonisë janë rreth 20.535 km², në Greqinë fqinje 6.843 km² dhe në veri të Republikës së Serbisë 1.210 km²(rrjedhat e epërme të Lepenecit dhe Pčinjës). Thellësia maksimale e lumit është 4 km (13ft.). Tipari kryesor i luginës së këtij lumi është karakteri i saj i përbërë ose poligjenetik, sepse, nëpërmjet shtetit tonë ai rrjedh nëpërmjet pesë luginave dhe katër kanjone. Ato alternojnë siç vijon: Lugina Poloska (63,5 km), Derven Klisura (21,5 km), Lugina e Shkupit (51 km), kanjoni Taorska (31 km),Lugina e velesit (7,5 km), kanjoni i Velesit (22 km), Lugina Tikvesh (55km), kanjoni i Demir Kapisë (19,5 km) dhe Lugina e Valandovës- Gevgelisë (30 km). Nga gjatësia e tërësishtme e Luginës së vardarit, dy e treta është (207 km) paraqet rrafshinë, kurse një e treta (94 km) është luginë. Në rrugëtimin nëpërmjet vendit tonë, Vardari pranon 37 degë më të gjata prej 10 km. 16 prej tyre rrjedhin nga ana e djathtë, kurse 21 nga ana e majtë.

Lumi Pčinja është dega e dytë nga e majta e lumit Vardar. Burimi ndodhet në territorin e Republikës së Serbisë, më saktësisht ndër majën Bela Voda e Malit Dukat, në lartësi prej 1.664 m, dhe në lumin Vardar rrjedh nga lugina Taorska në lartësi prej 191m. Gjatësia totale e rrjedhës së lumit është 135 km, me një lakim të vogël prej 10,9 ppm. Ka një vend për mbledhje të ujit prej rreth 2.840 km², nga të cilat 2.317 gjenden në Republikën e Maqedonisë. Në lumin Vardar mesatarja vjetore e pranimit të ujit është 16 m³/s. Uji minimal që rrjedh nga banja e Katlanovës është 1.30 m³/s dhe maksimumi është 16 m³/s. Nga burimi i tij, lumi Pčinja kthehet në një hark të madh kah jugperëndimi dhe jugu, dhe deri nën manastirin Shën Prohor Pčinjski ku hyn në territorin e Republikës së Maqedonisë, dhe nëpër të rrjedh me gjatësi prej 76 km. Prej daljes nga kanjoni afër fshatit Pelince, Pčinja hyn në luginën e Kumanovës, në të cilën zgjerohet lugina, dhe nga Mlado Nagoriçanë më është formuar një rrafsh i hedhur me hapësirë të gjërë, me një hapësirë prej 3.000 ha, me lartësi absolute prej 200-300 m dhe gjërësi prej 2km. Në këtë lokacion në luginën e Kumanovës, Pčinja rrjedh me një gjatësi prej 30 km, ka një shpat prej vetëm 2.5%, dhe këtu i pranon edhe degët e tij kryesore- Kriva Reka afër fshatit Kletçevçe dhe Lumi Kumanovska (Kumanovska Reka) afër fshatit Dobroshan.

Degët tjera kryesore të lumit Pčinja janë: Bistrica (17,5 km), Dragomanska Reka (11 km), Petroshnica (23 km) dhe Luka (17 km). Karakteristika kryesore e legenit të Pčinjës, e cila ka lartësi mesatare prej 760 m, është prezenca e procesit intenziv të erozionit. Si pasojë e erozionit

në disa vende të shtratit të lumit të këtij lumi si dhe tek degët e tij kemi sasi të madhe të materialit të depozituar, dhe uji i lumit Pçinja është rregullisht i turbulluar gjatë çdo rreshjeje.

Realizimi i aktiviteteve të nënproektit nuk do të shkaktojë ndikime negative mbi kualitetin dhe kuantitetin e ujërave të territorit të komunës së Petrovecit.

3.4. Klima

Klima në territorin e komunës së Petrovecit është kontinentale. Karakteristikat kryesore të kësaj klime janë dimër i ashpër dhe i lagësht, dhe verë e nxehtë dhe me thatësi. Vendi gjendet nën ndikimin e erërave të veriut dhe verilindjes, dhe në periudhën e verës kemi erëra lokale nga Skopska Crna Gora. Frekuencën më të lartë e ka era veriore (142%), pastaj: era verilindore (120%), juglindore (114%), era jugore (82%), veriperëndimore (81%), perëndimore (74%), dhe era lindore me frekuencë prek 56%. Temperaturat e ajrit janë identike me vlerat e njejta të të gjithë Fushën e Shkupit, ato janë minimale në muajin e janarit, dhe maksimale në korrik. Për shkak të ventilimit të zmadhuar, kemi edhe mjegull e cila paraqitet mesatarisht përreth 50 ditë, dhe të cilat karakterizohen me akull në mëngjes deri në fund të muajit prill. Rënia mesatare e shiut në vit gjithsej është përreth 504mm, duke arritur maksimumin në nëntor dhe maj. Periudha e thatësirës zgjat nga korriku deri në shtator me periudha të shpeshta të thatësirës që zgjasin më shumë se 60 ditë. Numri mesatar i ditëve me diell gjatë tërë vitit është 86, ditë të vrënjtur 184, dhe të errëta 96. Lagështia mesatare e ajrit është 70%.

3.5 Popullsia

Në territorin e komunës së Petrovecit egzistojnë 17 (shtatëmbëdhjetë) rajone të populluara rurale, të cilat janë të ndara në tre qendra rurale, sipas vendndodhjes së tyre:

-Petrovec- qendra e Vetëqeverisjes lokale, e cila përfshin edhe fshatrat: Rzaniçino, Ognjanci, Qojlija dhe Çiflik;

-Katlanova, e cila përfshin edhe fshatrat: Brezica, Gradmanci, Letevci, Badar, Blace dhe Kozhle;

-Konjarja e Mesme, e cila përfshin fshatrat: Konjare e Poshtme, Konjare e Epërme, Sushica edhe Divnje.



Fotografia 11 Harta e vendeve të banuara në komunën e Petrovecit.

Sipas vlerësimit në vitin 2016, komuna e Petrovecit ka 9.089 banorë.



Fotografia 12. Harta demografike e komunës së Petrovecit

3.6 Burime natyrore

Territori i Komunës së Petrovecit, sipas reljefit dhe konfiguracionit të terrenit, është e rrafshët dhe kodrinore.

Vendi total agricultural është prej 18.619 hektarë, nga të cilat:

-Tokë e lërueshme-7.309 hektarë;

- Kullotë- 5.438 hektarë

-Pyje-5.911 hektarë.

Në territorin e kësaj komune, si burime më karakteristike natyrore paraqiten: lumi Vardar, Pçinja dhe mali Gradishanska (fotografia 13).

Mali Gradishanska është një mal i ulët dhe mjaft i përçarë i cili zgjatet në drejtimin e JP-VL, gjendet mes rrjedhës së poshtme të Pçinjës në perëndim dhe Ovçe Pole në lindje, është i gjatë rreth 30 km. Ky mal është një rajon në të cilin kufizohen katër rajone dhe vende të Maqedonisë, dhe ato janë: Shkupi dhe Lugina e Shkupit (komuna e Petrovecit), nga veriperëndimi, Kumanova (komuna e Kumanovës) nga veriu dhe verilindja, Ovçe Pole (Sveti Nikole) nga lindja dhe juglindja, dhe Velesi (komuna e Velesit) nga jugperëndimi.

Gjërësia mesatare është rreth 9 km me gjërësi totale prej 230 km². Maja më e lartë është Gradishte ose Gjurishte (861m), pastaj vjen Venec (853m) e cila gjendet në pjesën qendrore, Goliç (790 m) në very dhe Crn Vrv në pjesëm jugore të malit. Mali është i mbuluar me bimë të ulëta dhe shkurre, siç kemi: *Cornus mas*, *Quercus coccifera*, jargavan i egër, si dhe drunj gjethërrënëse siç janë: lisi, shelgu, plepi dhe plepi i egër European. Në kuptimin hidrografik, ky mal është i karakterizuar me një numër të madh të burimeve të fuqishme dhe të pasura të ujit dhe përrockave të shkurta malore. Në pjesën perëndimore të malit, në hyrje të Katlanovës, afër Pçinjës, burojnë përrocka termale me ujë sherries mineral, nga ku është e ndërtuar edhe banja e njohur e Katlanovës. Në këtë mal kemi prezente këto lloje të faunës: *Rupicapra rupicapra*, dhëlpëra, ujq, nuselala, lepuj të egër dhe zogj të egër, *Phasianus colchicus*.



Fotografia 13 Mali Gradishtanska

3.7. Biodiverziteti

Në lokacionin se ku do të marrin pjesë aktivitete e proektit, nuk kemi rajone natyrale të mbrojtura ku egzistojnë lloje të ralla dhe të rrezikuara të botës bimore ose shtazore, kemi vetëm vegjetacione të egra, shkurre dhe bimë të ulëta.

- Në vendin më të gjërë të lokacionit ku do të marrin pjesë aktivitetet e proektit, do të thotë në territorin e komunës së Petrovecit gjendet asociacioni bimor Querci-Carpinetum orientales macedonicum Rudski apud Ht. Ky asociacion bimor është termofilik dhe kserofilik dhe dominohet nga Quercus Pubescens dhe shkoza e bardhë. Speciet e rëndësishme të bimëve me statusin e tyre në IUCN janë:
- *Quercus pubescens* - LC;
- *Fraxinus ornus*- LC;
- *Cornus mas*- LC;
- *Silene viridiflora* - NA;
- *Cyclamen hederifolium* - NA;
- *Ranunculus psilostachya* - LC;
- *Symphytum bulbosum* - DD;
- *Tamus communis* - NA;
- *Carpinus orientalis* - LC;

- *Acer monspessulanum*- LC;
- *Euonymus verrucosus*- LC;
- *Iris sintenisii* - NA;
- *Lithospermum purpurocaeruleum*- NA;
- *Saxifraga bulbifera*- NA;
- *Geranium sanguineum*-NA, etj

Në rrethinën e Katlanovës kemi asociacionin e bimëve Erythronio-Carpinetum orientalis. Në anën e majtë të lumit Pçinja kemi florë mjaft interesante, siç janë: *Erythronium dens-canis* (NA), *Galanthus gracilis* (DD), *Scillia bifolia* (LC), *Fritillaria graeca var. gussichiae* (DD), *Anemone ranunculoides* (NA), e Fauna në lumin Pçinja përfaqësohet nga gaforret e ujërave të ëmbla. Banues që shpesh e frekuenton Lumin Pçinja është bretkosa e gjelbër, sidomos në pjesët e lumit ku uji nuk rrjedh shpejtë. Në Katlanovë dhe Badar gjendet edhe breshka e ujit.

Rajone të mbrojtura në Komunën e Petrovecit

Në territorin e komunës së Petrovecit, kemi Katlanovski Predel(Rajoni i Katlanovës), dhe i cili është i caktuar si Monument i Natyrës që nga viti 1991.

Monumenti i natyrës gjendet në brigjet e majta dhe të djathta të lumit Pçinja dhe në bregun e majtë të lumit Vardar.

Ky vend i mbrojtur është me gjërësi prej 5442.6 hektarë dhe shtrihet në afërsi të fshatrave Katlanovë, Badar dhe Kozhle.


Në vendin e mbrojtur të Katlanovski Predel (Rajoni i katlanovës), karakteritikë kryesore e florës është dominimi i bimëve termale dhe kserofite, si dhe të asociacioneve bimore. Në këtë vend gjinden një numër i madh i bimëve mediterane (*Ruscus aculearis*, *Asparagus acutifolius*, *Jasminum fruticans*, *Rus coriaria*) kemi bimë të cilat gjenden në skaj të përhapjes veriore (nga Azia e Vogël deri në Maqedoni), siç janë: *Juniperus excelsa*, *Podocytisus Caramanicus*, *Astragalus ponticus*.

I gjithë vegjetacioni i drunjëve në këtë vend i takon pyjeve të lisit. Në rajonin e përmendur, është e shënuar prezenca e 75 llojeve të drunjëve dhe shkurreve. Në rajonin e fshatit Kozhle, në bregun e djathtë të lumit Pçinja në zonën më veriore të shtetit tonë është prezente *Juniperus excelsa*.

Në bregun e djathtë të lumit Pçinja ku gjendet Bansko Rid, vetëm disa metra larg lumit gjendet një terracë në të cilën është e vendosur Banja e Katlanovës.



Fotografia 14 Lokacioni i rajonit të Katlanovës në Rrjetin Nacional Emerald të Maqedonisë



Fotografia 15 Rajone të mbrojtura në Maqedoni të cilat janë të shënuara Katlanovski Predel (shigjeta e kuqe) dhe Katlanovsko Blato (shigjeta e zezë)

Katlanovska Banja (banja e Katlanovës)- Kjo zonë ëshët me lokacion 27 km në jug të Shkupit, në vendin ku lumi Pçinja kalon mes kodrës së katlanovës duke krijuar një kanjon të shkurtë, por shumë të bukur. Ndarja e dukshme tektonike e cila është e gjatë rreth 350 m, e bën këtë monument të natyrës tepër të rëndësishëm. Në shumë vende kemi prezente përrocka të ujit mineral të cilat përmbajnë ujë të pasur me gasëra. Uji paraqitet me pulsime periodik (fumarole) dhe është me prejardhje të re vulkanike. Lidhja e ruajtur mes ujit termal dhe çarjeve tektonike është me shumë rëndësi sa i përket banjës së Katlanovës, dukuri e rrallë jo vetën në gadishullin Balkanik, por gjithashtu në të gjithë Europën.

Karakteristika tjetër natyrore e këtij vendi është Katlanovsko Blato (moçali i Katlanovës).

Katlanovsko Blato (moçali i Kumanovës) paraqet rezervat ichtio-ornitologjik, gjendet afër Shkupit duke okupuar një vend prej 70 ha. Moçali është përkujtues i asaj çka mbetur nga ish-liqeni Neogjen i Shkupit. Deri në vitin 1968 ka përfaqësuar të vetmin vend natyral të shumimit të krapit dhe disa llojeve të tjera të peshkut të ujërave të ëmbla të lumit Vardar. Dikur ka qenë vendi më i rëndësishëm për pushim për një numër të madh të zogjëve migrues që kanë migruar nga edhe në Europë përmes drejtimit migrues Morava-Vardar.



Fotografia 16 Moçali i Katlanovës

Krahas moçalit të Katlanovës, edhe zona ekologjike Badar gjendet në këtë territor të mbrojtur. Vendndodhjen e ka mbas Katlanovës nëpërmjet lumit Pçinja dhe mbulon një rajon të madh, nga Katlanova deri te Crn Vrv. Ky lokalitet jo vetëm që ka natyrën tepër të bukur, por është edhe zonë me shumë gjëra të rralla të natyrës.

Lokacioni ku do të ndodhin aktivitetet të projektit gjendet në largësi të sigurtë nga moçali i Katlanovës, banja e Katlanovës dhe Badarit (rrespektivisht 3,5 km, 4 km dhe 2,2 km), dhe aktivitetet e parashikuara nuk do të shkaktojnë ndonjë ndikim negativ mbi këto burime natyrale.



Fotografia 17 Pozita e villa Vangelina në relacion me moçalin e ktlanovës, banjës së Katlanovës dhe Badarit (burim:Google Earth)

3.8 Trashëgimia kulturore

Në suaza të Komunës së Petrovecit kemi disa kisha dhe manastire më të vjetra mesjetare, siç janë: manastiri i shekullit 18 'Shën Spas' në fshatin e Kozhles, kisha 'Shën Trojca' në fshatin Cjojlina, kisha 'Shën Gjergji', në fshatin e Petrovecit. Në fshatin e Katlanovës, kemi kishat 'Shën Nikola' dhe 'Sveta Nedela' e cila gjendet afër Banjës së Katlanovës. Kisha 'Shën Gjergji fitimtari' paraqet një kishë të fshatit e cila ka qenë e ndërtuar në periudhat mes shekullit 16 dhe 17.

Në territorin ku do të marrin pjesë aktivitetet e proektit, nuk egziston trashëgimi kulturore për tu rrezikuar.

4 Ndikim social dhe ndaj rrethinës jetësore

Realizimi i aktiviteteve të planifikuara të nënproektit 'Renovim, rindërtim dhe zgjerim i Vila Vangelina në kodrën e gjelbër të Katlanovës', do të shkaktojë disa ndikime sociale dhe ndaj rrethinës jetësore. Plani për menaxhim social dhe rrethinë jetësore ka për

qëllim të vlerëson ndikimet e mundshme sociale dhe ndaj rrethinës jetësore që mund të vijnë nga aktivitetet e parashikuara të projektit.

Ndikimet ndaj rrethinës jetësore të këtij tipi të aktiviteteve të projektit janë të kategorizuara në dy tipe kryesore të aktiviteteve:

-Faza e rindërtimit (rindërtimi dhe renovimi i apartamenteve, instalimi i pajisjeve për kuzhinë, restaurant, aktivitete për rregullimin e sheshit të lodrave të fëmijëve etj)

-Faza operative (feksionimi i Villa Vangelinës dhe të gjitha strukturat e parapara ndër këtë nënprojekt).

4.1. Emetimet në ajr

Lokacioni ku do të mer pjesë nënprojekt është në një vend mjaft të qetë, pa komunikacion intenziv i cili do të mundej të ndikon në rrethinën jetësore në mënyrë dramatike dhe të shkaktojë ndotje të ajrit. Me aktivitetet e rindërtimit dhe renovimit dhe me përdorimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së planifikuar, nuk priten ndryshime të konsiderueshme në kualitetin e ajrit, sepse aktivitetet e rindërtimit do të jenë afatshkurta dhe të limituara në rindërtim të apartamenteve dhe rregullimit të pjesërishëm të vendit për parkim veturash dhe sheshit për lodëra fëmijësh. Nuk priten emitime shtesë nga ngrohja ose ftohja e apartamenteve, sepse për këtë qëllim parashihen përdorime të rrymës elektrike.

Faza e rindërtimit dhe e rinovimit

Gjatë kësaj faze janë të parapara këto ndikime mbi kualitetin e ajrit:

-Emitime të pluhurit që shpërndahet nga aktivitetet e rindërtimit të apartamenteve, sallës së konferencave, rregullimit dhe mbledhjes së vendit për parkim të veturave dhe sheshit të lodrave të fëmijëve, si dhe prej instalimit të pajisjeve për sheshin e lodrave të fëmijëve;

-Emitime të gazrave të shkarkuara nga makinat e ndërtimit dhe nga automjetet e transportit;

-Emitimi i komponenteve të përbëra të paqëndrueshme organike nga ngjyrave dhe bojërave nga aktivitetet e rindërtimit dhe renovimit të apartamenteve egzistuese.

Pluhuri i cili gjenerohet nga intervenimet mekanike të mekanizmave të ndërtimit nga aktivitetet e rindërtimit të apartamenteve, puna me zhavor nga rregullimi i parcelave dhe djegja e lëndëve djegëse nga makinat e ndërtimit gjatë aktiviteteve të këtij lloji, ka ndikim mbi rrethinën jetësore që gjindet pranë varësisht nga përmasat e

grimcave(diametër aerodinamik), dhe varësisht nga kushtet gjatë ndërtimit, kryesisht nga shpejtësia e erës (e cila ka ndikim mbi transmetimin ose shpërndarjen e tyre).

Emetimet e gazrave në ajr do të shkaktohen nga makinat e ndërtimit. Ndostësit më të zakonshëm që prodhohen nga gazrat e shkarkuara janë elementet SO₂, NO_x, CO, PM₁₀, karbohidratet e padjegura, sulfuri , plumbi, benzina dhe hidrokarbonatet e tjera aromatike të cilat kontribuojnë në prodhimin dytësor të ozonit, dhe të gjitha këto paraqiten si kanosje direkte ose indirekte ndaj shëndetit të njeriut ose ndaj rrethinës jetësore.

Lloji dhe sasia e gazrave të shkarkuara fillimisht do të varet nga lloji i lëndës djegëse, gjendjes së përgjithsme të automjeteve, shpeshtësia e lëvizjes dhe kohëzgjatja e aktiviteteve të ndërtimit. Megjithatë, kualiteti i lëndëve djegëse në këtë shtet ndjek standardet Europiane dhe kontrollohet nga laboratore të akredituara. Prandaj mund të përfundojmë se emitimet nga burimet lëvizëse të angazhuara në suaza të këtij nënproekti nuk paraqesin kanosje madhore ndaj kualitetit të ajrit.

Emetime në ajr dhe ndikime të mundshme ndaj kualitetit të ajrit gjithashtu mund të priten nga automjetet të cilat transportojnë material dhe mjete në vendin e nënproektit dhe të cilat transportojnë mbeturina jashtë këtij lokacioni (ndikim lokal, i limituar në lokacionin e renovimit/rindërtimit që ndodh vetëm në fazën e rindërtimit).

Emetimet që shpërndahen nga komponentet të paqëndrueshme organike nga përdorimi i ngjyrave dhe bojërave do të ketë më pak ndikim, sepse këto përbërës (të përdorura në kuantitete më të vogla për punë përfundimtare tek apartamentet) shumë lehtë avullojnë shumë shumë pak rrijnë në ajr. Kontratuesi duhet të përdorë ngjyrëra dhe llakëra eko-miqësore që ta zvogëlojë në minimum ndikimin ndaj rrethinës.

Gjatë kësaj faze, pranuesit më të ndjeshëm që do të jenë të ekspozuar ndaj emetimeve në ajr do të jenë punëtorët e angazhuar. Ndikimi në kualitetin e ajrit mund të vlerësohet si afatshkurtë, lokal, indirect, i kthyeshëm dhe me intenzitet të ulët të ndikimit ndaj rrethinës.

Faza operative

Në fazën operative efekti mbi kualitetin e ajrit do të ndodhë nga automjetet të cilat arrijnë në lokacionin e Vila Vangelinës duke përdoritur vendimin e parkimit të veturave. Ky do të ishte ndikim afatgjatë me rëndësi minimale mirëpo që do të ndodhte në mënyrë të përsëritur, si dhe me karakter lokal.

4.2. Emetimet në ujë

Faza e rindërtimit dhe renovimit

Në suaza të aktiviteve të planifikuara në këtë nënproekt dhe të cilat do të kryhen në vend, nuk pritet që të kemi emetime në ujërat nëntokësore ose sipërfaqësore. Në rrethinën e lokacionit nuk ka rrjedhje ujore të cilat do të ndikoheshin nga këto aktivitete të proektit.

Është shumë me rëndësi gjithashtu që të evitohen rrjedhje aksidentale të vajërave ose lëndëve djegëse nga automejete dhe makinat që do të përdoren gjatë rindërtimit të cilat do të kishin kontakt direkt me tokën, dhe në këtë mënyrë do të kishin edhe kontakt indirekt me ujërat nëntokësore-sipërfaqësore. Kontraktuesi duhet të ketë kujdes mos të derdhen ngjyrëra në pellgjet egzistuese. Menazhimi i jokujdesshëm i mbeturinave gjithashtu mund të shkaktojë emetime në tokë dhe në ujërat nëntokësore. Nëse nuk respektohen masat preventuese të cilat detajisht janë të dhëna në Planin për Zbutje të prezantuar më poshtë, ka mundësi që këto emetime të shkaktojnë ndikime afatgjata dhe të rëndësishme në sipërfaqe, në ujërat nëntokësore dhe në tokë.

Faza operative

Në fazën operative, burimet e emetimeve në ujë në përgjithësi do të jenë të njejta siç kanë qenë deri tani (nga përdorimi sanitar dhe higjienik i vizitorëve, pregaditja e ushqimit në restaurant etj.). të gjitha ujërat e zeza do të mbledhen në jamën egzistuese septike e cila është rezistente ndaj rrjedhjes (5mx5mx3m=75m³).

4.3. Emetimet në tokë

Efektet nga aktivitetet e proektit priten që të jenë të zbutura me implementimin e duhur të masave për mbrojtje të tokës gjatë aktiviteve të planifikuara të proektit. Kontraktuesi duhet të vendos një sistem për menaxhim të duhur të mbeturinave, ashtu që mos të ketë mbeturina që do të mbeten në tokë dhe mbeturinat municipale të mbledhura nga punëtorët e angazhuar parashihet të mbledhen në kontejnerë të përshtatshëm dhe më vonë të transportohen nga vendi nga kompanitë e autorizuara. Kontraktuesi nuk do të lejon asnjë rrjedhje të vajit të motorëve nga automjetet të cilat do të përdoren për të kryer aktivitetet e parapara të proektit. Aktivitetet e proektit duhet të kryhen në atë mënyrë që të parandalohen emetime aksidentale në tokë, si dhe të parandalohen dëmet mbi strukturën e tokës nga lëvizja e automjeteve dhe makinave të ndërtimit. Emetime të mundshme të paqëllimshme mund të përfshijnë rrjedhjet e lëndës djegëse, vajit, lubrikantëve dhe kemikalet tjera, si dhe erozioni i shtresës së lartme të tokës për shkak të punimeve në të. Kontraktuesi gjithashtu duhet të ketë parasysh edhe masat e parandalimit dhe të zbutjes të planifikuara në Planin e Zbutjes, siç është i prezantuar më

poshtë, që të mund të parandalohen rrjedhjet e mundshme të lëndës djegëse ose vajit të motorit nga makinat në tokë.

Faza e rindërtimit dhe e renovimit

Në këtë fazë, mund të ndodhin ndikimet vijuese:

-Rrjedhje të mundshme të paqëllimshme të lëndëve djegëse ose vajrave nga makinat e ndërtimit, një proces i cili mund të shkaktojë efekte mbi ujërat tokësor;

-Menaxhim joadekuat i mbeturinave të mbledhura në objekt.

Faza operative

Në fazën operative, emetimet e gazrave të shkaktuara të cilat vijnë nga automjetet të cilat arrijnë në këtë lokacion dhe përdorin hapësirën e parkimit do të kenë më pak intenzitet dhe ndikim në tokën.

Mund të konkludojmë se realizimi i aktiviteteve të proektit të Vila Vangelinës nuk do të shkaktojë ndikime të mëdha negative mbi tokën.

4.4 Zhurma

Nocioni 'zhurmë' nënkupton çdo zë të pakëndshëm të cilin ka vështirësi ta duron veshi i njeriut. Zhurma, si fenomen i komplikuar fizik varet nga intenziteti, kohëzgjatja dhe shpeshësia: ajo ka ndikim negativ mbi gjendjen psiko-fizike të njeriut dhe mundet përkohësisht ose përgjithmonë ta dëmton dëgjimin.

Faza e ndërtimit dhe e rinovimit

Gjatë rindërtimit të aktiviteteve të parapara të proektit do të kemi nivele të zmadhuara të zhurmës që do të vjen si rezultat i punës së mjeteve dhe makinave të ndërtimit që janë të angazhuara në rindërtimin e apartamenteve , zgjërimit të vendit të parkimit, rregullimit të parcelave/peisazhit, instalimit të mjeteve për sheshin e lodrave të fëmijëve. Gjithashtu, zhurma do të krijohet nga automjetet të cilat transportojnë materiale dhe mjete deri tek lokacioni i nënproektit dhe të cilat do të transportojnë mbeturina jashtë lokacionit.

Paraqitja e zhurmës nga makinat e ndërtimit gjatë punës do të kenë ndikim shumë të vogël negativ prej faktit se do të ketë kohëzgjatësi të limituar dhe karakter lokal. Emitimi i zhurmës mund të jetë i parëndësishëm fare nëqoftëse Kontraktuesi përdor automjete dhe makina

ndërtimi në pajtim me standardet teknike dhe nëse punët e ndërtimit bëhen gjatë ditës (orët 7-19)

Nuk do të ketë zhurmë nga mjetet elektrike gjatë aktiviteteve për renovime të apartamenteve, mirëpo ndikimi në rrethinën e afërme do të ishte i parëndësishëm.

Largësia nga vendet e popullsuara, karakteristikat gjeologjike dhe konfiguracioni i terrenit është shumë i rëndësishëm për ndikimin e zhurmës në rrethinë.

Sipas rregullores për lokacionet e stacioneve të vëzhgimit dhe pikave të matjes ('Gazeta zyrtare e RM'nr. 120/08), lokacioni i proektit në Rajon me shkallë IV të mbrojtjes ndaj zhurmës në vend të paraparë për aktivitete industriale dhe përpunuese, dhe aktivitete tjera të cilat mund të shkaktojnë zhurmë me intenzitet më të lartë (për shkak të afërsisë relative ndaj Aeroportit Internacional të Shkupit). Në këtë rajon lejohen nivelet vijuese të zhurmës: Ld-ditë (periudhë nga 07:00 deri 19:00- 70 dB, Lv –mbrëmje (periudhë prej 19:00 deri 23:00)- 70 dB dhe Ln natën (periudhë prej 23:00 deri 07:00)- 60 dB.

Në këtë rajon nuk ka vende banuese ose vende të ndjeshme të lokacionit se ku do të bëhen aktivitetet e proektit, prandaj nuk mund të ketë ndikime negative mbi popullatën lokale si rezultat i zhurmës e cila do të gjenerohet në këtë vend.

Faza operative

Në fazën operative, zhurma do të gjenerohet nga vizituesit të vendit të cilët do të përdorin të gjitha strukturat dhe nënstrukturat e parapara me këtë nënproekt dhe nga automjetet të cilat do të arrijnë në lokacion dhe do të përdorin hapësirën e parkimit. Zhurma e krijuar nuk do të shkaktojë ndikim të konsiderueshëm negativ mbi rrethinën.

4.5 Krijimi dhe menaxhimi i mbeturinave

Gjatë kryerjes së aktiviteteve të parashikuara të nënproektit, do të ndryshojë kuantiteti i mbeturinave të krijuara nga aktivitetet e nënproektit.

Faza e rindërtimit dhe e renovimit

Krijimi i mbeturinave nga aktivitetet e rindërtimit dhe të zgjërimit mundën mundësisht të ndotin rrethinën jetësore në afërsi nëse nuk menaxhohet në mënyrë të përshtatshme. Kryesisht, mbeturinat e krijuara në këtë fazë do të jenë të palëvizshme (teprica e tokës së gërmuar nga zgjërimi i hapësirës së parkimit si dhe mbetje të betonit, tullave, dhe do të ketë pjesë të vogël të materialeve recikluese (siç është letra, plastika, druri ose qelqi). Sipas Listës së tipeve të mbeturinave, mbeturinat e tubuara gjatë kësaj faze mund të kategorizohen si mbeturina të përziera komunale të tubuara nga punëtorët, mbeturina nga vendndërtimi,

mirëpo gjithashtu do të egzistojnë edhe sasi të vogla të mbeturinave të rrezikshme, shembull nga derdhja e paqëllimshme e vajit të makinave, lubrikante, lëndë djegëse dhe tjera substanca të rrezikshme ose paketime të kontaminuara. Mbeturinat biodegraduese nga pastrimi i terrenit dhe pastrimi i vegjetacionut gjithashtu do të tubohet në këtë fazë, gjithashtu do të tubohen edhe materialet minerale nga grierjet për rregullimin e hapësirës së lodrave të fëmijëve. Mbeturina të parrëzkishme gjithashtu mund të krijohen nga blerja dhe instalimi i mjeteve (letër, karton, plastikë dhe tjera materiale sintetike) dhe nga paktimi i mjeteve (mbeturina të paketimeve). Mbeturina të rrezikshme nga pakimet mund të tubohen nga përdorimi i bojërave dhe llakërave. Nga aktivitetet për rinovim të apartamenteve, instalimi i mjeteve të reja dhe mobiljeve, do të tubohen mbeturina siç janë: kompensatë druri, dërrasa të gipsit, si dhe dru, metale, qelq, plastikë, pjesë të tullave, mbeturina të rrezikshme, mbetje të bojërave dhe ngjitësve dhe paketimeve të tyre.

Mbeturinat e palëvizshme të ndërtimit të cilat do të krijohen janë të kategorizuara si mbeturina të parrezikshme. Mirëpo ende egziston nevoja që të ketë një vend të planifikuar se du do të tubohen përkohësisht këto mbeturina. Këto mbeturina (shembull, teprice e materialit të tokës, beton, gurrë të thyer dhe tulla etj), mund të mbulojnë sipërfaqe të mëdha dhe mund ta çrregullojnë peisazhin. Kuantitetet më të mëdha të tokës së gërmuar nga rregullimi i hapësirës për parkim dhe hapësirës së sheshit të lodrave do të përdoret për shtim të madhësisë dhe do të rruhet për përdorim të mëtutjeshëm nëpër sipërfaqe të përkohshme ose do të transportohet në deponim ligjor. Nëse aplikohet menaxhimi i mirë dhe duke përdorur teknikat më të mira të mundshme për punë të ndërtimtarisë, atëherë do të kemi kuantitete minimale të mbeturinave. Kontraktuesi ka për obligim të menaxhoj mirë mbeturinat në lokacionin e caktuar.

Mbeturinat e tubuara nga ndërtimi do të transferohen në deponimin ligjor më të afërt. Mbeturinat nga rindërtimi i apartamenteve dhe nga aktivitetet e tjera do të mblidhen në një lokacion të përkohshëm dhe më pas do të transportohen nga 'PE Petrovec' ose ndonjë firmë tjetër juridike me leje të përshtatshme dhe do të vendoset në deponim tjetër legal.

Faza operative

Në fazën operative, mbeturinat e ngurta komunale do të mblidhen nga vizituesit dhe nga të punësuarit në këtë lokacion ku ka shporta të vendosura të mbeturinave dhe kontejnerë, ku mbeturinat do të tubohen në mënyrë të rregullt.

4.6. Ndikimet mbi natyrën, habitatet dhe llojet(bimore ose shtazore)

Me realizimin e këtij nënprojekti nuk do të ketë ndikime të rëndësishme mbi biodiversitetin.

Në lokacionin ku do të marrin pjesë aktivitetet e projektit, nuk ka vende të mbrojtura natyrore dhe nuk ka lloje të rralla ose të rrezikuara, kemi vetëm vegetacion të vrazhdë shkurre dhe bimë me kërcej të ultë.

Aktivitetet që do të ndërmerren në këtë vend dhe që janë të propozuara për këtë projekt do të jenë të planifikuara dhe të implementuara me kujdes me qëllim të mos shqetësohet flora, fauna dhe habitatet rrethuese.

Faza e rindërtimit dhe e renovimit

Në këtë fazë, ndikimet mbi biodiversitetin rrethues do të ndodhin si rezultat i përdorimit të makinave ndërtuese, nëpërmjet krijimit të zhurmes, emetimit të pluhurit që do të shpërndahet dhe emetimit të gazrave, si dhe prej numrit të madh të të punësuarve që do të gjenden në atë lokacion. Gjithashtu, kemi rrezik prej nisjes së paqëllimshme të zjarrit dhe menaxhimit të papërshtatshëm të mbeturinave. Këto ndikime janë lokale dhe janë të kufizuara tek lokacioni në të cilin kryhen aktivitetet e rindërtimit, dhe mundësia që të ndodhin të lartëpërmendurat është e vogël nëse kemi mbikqyrje të përshtatshme.

Faza operative

Në vendin ku do të kryhet rindërtimi nuk kemi rajone të mbrojtura natyrore dhe nuk kemi lloje të rralla dhe të rrezikuara, prandaj ndikimet konsiderohen të jenë minimale nëse zbatohen masat e përshtatshme të zbutjes së tyre.

4.7 Ndikimet sociale

Projekti nuk kërkon përvetësim të tokës prandaj nuk kemi ndonjë ndikim social për shkak të përvetësimit të tokave dhe probleme me rilokim. Gjatë aktiviteteve të rindërtimit mund të kemi disa probleme profesionale, shëndetësore ose sigurie për të punësuarit për shkak të zhurmës së zmadhuar, emetimet e pluhurit që shpërndahet, emetimit të gazrave etj. Megjithatë, këto ndikime do të jenë afatshkurta dhe të kufizuara në vendin ku do të marrin pjesë aktivitetet e projektit.

Implementimi i këtij nënprojekti pritet të sigurojë beneficione pozitive socio-ekonomike në rajon përmes mundësive të reja për punësim, si dhe përfitime të tjera sociale. Përfitimi më i madh do të paraqet mundësia për zhvillimin e turizmit rural dhe rritja e ekonomisë lokale. Vendosija e këtij lokaliteti në hartën turistike do të mundësojë informim më të mirë për turistët dhe do të krijojë mundësi për zhvillim të mëtutjeshëm. Me këtë, benefitet pozitive socio-ekonomike të cilat do të rezultojnë nga ky projekt do të tejkalojnë efektet negative mbi natyrën dhe rrethinën, që justifikon implementimin e aktiviteteve të këtij projekti.

5: Masa të zbutjes

Masat e zbutjes të cilat përshkruhen në këtë pjesë janë të përgjithshme, dhe masat e zbutjes obligative janë të dhëna më detajisht në një tabelë në kapitull të posaçëm në Planin për Zbutje dhe Monitorim.

Kontratuesi duhet të pajtohet me të gjitha kërkesat që të mund ti eliminon mundësitë për lëndime të të punësuarve dhe problemeve tjera profesionale, shëndetësore dhe sigurie, si dhe për popullsinë lokale, turistët dhe vizitorët. Të gjitha aktivitetet për rindërtim, renovim dhe zgjerim duhet të kryhen nga punëtorët profesionalisht të trajnuar. Palët që janë përgjegjëse për implementimin e masave për zbutje të përcaktuara në këtë ESMP janë:

1. Kontraktuesi, (kompani e zgjedhur nëpërmjet procedurës e tenderit/prokurimit)
2. Inxhinier- mbikqyrje
3. Aplikuesi/përfituesi (Global Centar DVD DOOEL, Kmanovë).

5.1 Ajri

Gjatë aktiviteteve të parashikuara të proektit duhet të implementohen masat vijuese preventive me qëllim të minimizohen ndikimet e identifikuar negative mbi kualitetin e ajrit:

- Periudha të planifikuara me kujdes për punë në këtë lokacion
- Kufizimi i komunikacionit të panevojshëm në vendin ku janë duke u kryer punët e rindërtimit dhe të zgjerimit;
- Përdorimi i lëndëve kualitative djegëse për automjetet (sipas standardeve nacionale);
- Përdorimi i mjeteve mbrojtëse personale nga ana e punëtorëve;
- Sigurimi i masave për mbrojtje të automjeteve dhe mjeteve-sidomos, masa për mirëmbajtjen e instalimit të gypave shkarkues, filterëve të vajit të motoreve, dhe servisim i rregullt i mjeteve dhe makinave të ndërtimit që të mos ndodhin rrjedhje dhe emetime të panevojshme.

5.2 Uji

Gjatë aktiviteteve të parapara të proektit, duhet të aplikohen masat vijuese parandaluese që të minimizohet ndikimi negativ mbi ujërat sipërfaqësorë ose nëntokësorë.

- Mirëmbajtje e rregullt e automjeteve dhe makinave të ndërtimit dhe riparime të kohëpaskohshme në pajtim me procedurat me qëllim që të evitohen rrjedhjet ose emetimet. Mirëmbajtja dhe riparimet e automjeteve dhe makinave të ndërtimit nuk lejohet në të ashtuquajturin vendndërtim.;
- Automjetet dhe makinat e ndërtimit duhet ti përdorin rrugët egzistuese;
- Selektim i kujdesshëm i lokacionit për ruajtje të përkohshme të materialit ndërtimor, hedhja e mbeturinave të ndërtimit deri te gropat deponike të licencuara (të aprovuara nga Komuna e Petrovecit);
- Toka e gërmuat/materiali tepricë i tokës (nëse ka) duhet të vendoset në lokacion të përkohshëm dhe në mënyrë adekuate;
- Të gjitha materialet e rrezikshme dhe mbeturinat e rrezikshme janë të ndara veças dhe të etiketuara në kontejnere me sistem dytësor të ruajtjes.

5.3. Toka

Gjatë aktiviteteve të parapara me këtë proekt, duhet të implementohen masat preventive vijuese me qëllim që të minimizohen ndikimet negative në tokë:

-Planifikim i kujdesshëm për të gjitha punët e proektit me qëllim që të zvogëlohen efektet negative dhe të parandalohet kontaminimi i tokës:

-Zvogëlim i madhësisë së vendndërtimit me qëllim që të minimizohet sipërfaqja tokësore e cila do të vuajë ndikim të pafavorshëm (të gjitha ndërtimet e parapara dhe aktivitetet për zgjërime duhet të kryhen në atë vend, i cili është i planifikuar për implementimin e aktiviteteve të proektit);

-Lëvizje e kufizuar e automjeteve dhe përdorim të makinave me qëllim të shtypjes më të vogël të sipërfaqes tokësore dhe që të ketë më pak vibracione;

- Të gjitha materialet të rrezikshme siç janë lëndët djegëse, bojërat dhe llakërat, lubrikantet, ngjitëset dhe mbeturinat nga paketimet duhet të jenë të vendosura në kontejnerë të posaçme rezistente ndaj rrjedhjes (të përshtatshme për pranim dhe rruajtje të të gjitha llojeve të materialeve) të cilat gjenden në vendin e ndërtimit, të mbrojtura nga kushtet ekstreme të motit (shi, erë);

- Mbrojtje e materialeve të ndërtimtarisë dhe ndalimi i aktiviteteve të ndërtimtarisë në kushtet e shirrave të rrëmbyeshme;
- Rajoni i vendnërtimit duhet të jetë i kufizuar dhe i shënuar në mënyrë të përshtatshme. Shënimi i përshtatshëm i vendit të rindërtimit dhe të renovimit duke shënuar lokacionin e përshtatshëm për ruajtje të përkohshme të materialit ndërtimor në vend dhe duke vendosur shirita paralajmërues;
- Groposjet ku do të vendoset teprica e materialit të gëryer duhet të ketë leje ose miratim të përshtatshëm;
- Nëse kemi rast të tokës së kontaminuar nga lëshimi eventual i vajrave nga makinat ndërtimore, vaji i kontaminuar duhet të largohet dhe të trajtohet si mbeturinë e rrezikshme dhe për trajtimin e mëtutjeshëm të mbeturinës së rrezikshme, Kontraktuesi duhet të veprojë në pajtim me Artikullin 57 e Ligjit të Menaxhimit të Mbeturinave ('Gazeta zyrtare e RM' nr. 68/04, 71/04, 107/07, 102/08, 134/08, 82/09, 124/10, 09/11, 47/11, 51/11, 163/11, 123/12, 147/13, 163/13, 51/15, 146/15, 156/15, 39/16, 63/16).

5.4 Zhurma

Gjatë aktiviteteve të zgjërimit, renovimit dhe rindërtimit duhet të ndërmerren masat vijuese preventive me qëllim të minimizohet ndikimi negativ nga zhurma:

-Niveli i zhurmës nuk duhet të tejkalon 70dB gjatë ditës dhe gjatë natës, si dhe puna e ndërtimtarisë do të kryhet gjatë natës(orët e renovimit 07:00 deri më 19:00);

-Vendosja e regjimit të posaçëm për komunikacionit e automjeteve të kontraktuesit gjatë periudhës së rindërtimit, renovimit dhe zgjërimit me sinjalizim të përshtatshëm;

Aktivitetet e ndërtimit duhet të planifikohen në mënyrë adekuate që të zvogëlohet koha e përdorimit të mjeteve të cilat krijojnë zhurmë me intenzitet të konsiderueshëm;

-Ngaqë vendi është rural, dhe ngaqë në afërsi të lokacionit nuk kemi vendbanime, atëherë zhurma e krijuar nuk do të ketë ndikim negativ mbi njerëzit;

- Gjatë punëve mbulesat e motorëve, gjeneratorëve, kompresorëve të ajrit dhe tjerave mjete me fuqi mekanike duhet të mbyllen, dhe makinat dhe mjetet duhet të vendosen sa më larg vendeve banuese;

-Përdorimi i praktikave më të mira të ndërtimit me theks të madh në nivelet e zhurmës.

5.5 Mbeturinat

Gjatë aktiviteteve të parashikuara të proektit, duhet të implementohen masat vijuese preventive me qëllim që të kemi sa më pak ndikim negativ nga mbeturinat:

-Identifikimi dhe klasifikimi i mbeturinave sipas Listës nacionale të Mbeturinave ('Gazeta zyrtare e R.Maqedonisë' nr. 100/05);

-Vendosja e kontaktit me mbledhësit e autorizuar të mbeturinave, transportuesve të llojeve të ndryshme të mbeturinave dhe sigurimi i vendosjes/ruajtjes së sigurtë të tyre. Mbeturinat e mbledhura duhet të rruhen në lokacione të veçuara në vendin e ndërtimit, të shënuara ose të etiketuara sipas llojit të mbeturinës (rrezikshëm/parrezikshëm/inerte) deri në momentin e mbledhjes, transportimin dhe largimin e tyre përfundimtar. Automjetet të cilat transportojnë mbeturinat nga vendndërtimi duhet të jenë të mbuluara që të evitohet shpërndarja e tyre;

-Mbeturinat nga aktivitetet e renovimit të apartamenteve duhet të dorëzohen deri tek kompania e autorizuar e cila posedon leje nga autoritetet kompetente –MOEPP;

- Aktivitetet e rindërtimit, renovimit dhe zgjerrimit do të mbarojnë(finishojnë) vetë pasi të jenë larguar materialet e mbeturinave (nuk do të lihen mbeturina në vendin e ndërtimit)/(do të mbledhen nga kompania e autorizuar);

-Do të jetë e ndaluar djegia e mbeturinave në vendndërtim;

- Mbeturinat e mbledhura duhet, nëqoftëse është e mundur të ripërdoren si material ndërtimor (me lejen e inxhinierit-mbikqyrës, përdoruesit dhe Ekspertit rrehinor LRCP);

-Mbeturinat e ndërtimtarisë duhet të largohen në groposje të licencuar e caktuar nga Komuna;

- Mbeturinat që do të krijohen nga punëtorët e angazhuar në atë vend duhet të mbledhen, të transportohen dhe të largohen në groposje e cila i plotëson standardet elementare në pajtim me aktet legale, dhe me aplikimin e praksave më të mira për menaxhim të mbeturinave.

5.6 Biodiverziteti (flora dhe fauna)

Është e rekomanduar që si masë për zvogëlimin e ndikimit nga përdorimi i makinave ndërtuese (vibracionet, zhurma dhe emetimet e zmadhuara) të përdoren makina të duhura për

ndërtimtari, elemente të duhura teknike dhe përdorim i lëndëve djegëse adekuate. Gjurmët nga punët e ndërtimit duhen të zvogëlohen në minimum në vendndërtim në kohën e planifikimit të saj. Është e ndaluar të mblidhen drunj për të ndezur zjarr nga dhe përreth vendit të punës. Maltretimi i kafshëve dhe mbledhja e bimëve në atë rajon janë të ndaluara rreptësisht.

6. Plani për menaxhin social dhe i rrethinës jetësore (si dhe për Zbutje dhe Monitorim)

6.1. Plani për monitorim

Kompania në fjalë- Global Center DVD LTD eksport-import, Kumanovë dhe komuna e Petrovecit kanë përgjegjësi për ta harmonizuar projektin me rrethinën jetësore, të implementojnë projektin dhe të operojnë në suaza të legjislacioneve nacionale, të kësaj ESMO dhe në suaza të masave të cilat i definon, si dhe në suaza të ESMF (Kudri për menaxhin social dhe të Rrethinës jetësore) të të gjithë projektit. Monitorimi i aspekteve sociale dhe të rrethinës jetësore, siç është e definuar në planin e Monitorimit, paraqet përgjegjësi e Global Center DVD LTD eksport-import, Kumanovë. Global Center DVD LTD eksport-import Kumanovë do të dorëzon raporte mbi punët e rrethinës jetësore dhe implementimin e masave për mbrojtje të rrethinës jetësore, si dhe mbi përparimin e PIU,(Njësia e Implementimit të Proektit) në raportet e përparimit të projektit, si dhe në suaza të raporteve tremujore gjatë periudhës së implementimit.

Plani i pregaditur për Menaxhim social dhe të Rrethinës jetësore për këtë nënprojekt do të jetë pjesë e tenderit dhe dokumentacionit për marrëveshje për të gjitha aktivitetet e projektit. Kontraktuesi do të jetë i obliguar të implementon masat e parashikuara sipas Planit të Zbutjes. Inxhinieri-mbikëqyrës ka për obligim të monitoron dhe të vlerëson implementimin e masave të propozuara në suaza të Planit për Monitorim dhe sipas kësaj ti informon investuesit.

Në procedurën e vlerësimit të ndikimeve gjatë dëgjimeve publike do të jetë i përfshirë edhe publiku në komunën e Petrovecit. Komentet e dorëzuara do të jenë të përfshira në raportin e dëgjimeve publike, i cili do të paraqitet si pjesë shtesë e planit. Në këtë mënyrë, të gjitha komentet e publikut do të jenë në dispozicion për aplikuesit, dhe të gjitha komentet relevante dhe përgjigjet do të përmbledhen në ESMP-në përfundimtare.

Implementimi i Planit për Menaxhim Social dhe të rrethinës jetësore dhe aspektet sociale do të mundësojnë ndërmarrje në kohë të duhur të masave të propozuara dhe do të kontribuojnë në realizimin e aktiviteteve të projektit pa ndikime të rëndësishme ndaj rrethinës jetësore.

Plani për Zbutje

Aktivitete	Ndikimi i pritur ndaj rrethinës jetësore	Masa për Zbutje	përgjegësia e implementimit të Masës së Zbutjes	Peridha e implementimit të masës për Zbutje	Shpenzimet në lidhje me implementimin e masave për zbutje
Faza e përgatitjes					
Përgatitja e dokumentacionit të dizajnit, kushte të përgjithshme etj.	Ndikime të mundshme negative sociale dhe shëndetsore ndaj punëtorëve, përdoruesve dhe popullatës lokale si rezultat i mosveprimit ndaj masave të sigurisë	<ul style="list-style-type: none"> - Planifikimi i kohës së nisjes së aktiviteteve të projektit; - Publiku është i informuar për punët nëpërmjet Njohtimit në Tabelën e Njohtimit së Komunës, përmes webfaqes së kompanisë dhe mjeteve tjera nëse ka nevojë; - E gjithë puna do të kryhet në mënyrë të sigurtë dhe të disiplinuar; - Të gjitha lejet, mendimet ose vendimet e nevojshme kanë qenë të marra para se të fillon procesi i punës, duke përfshirë edhe miratimin EIA; - Inspeksionet lokale të profesioneve, të sigurisë dhe shëndetit (OHS) kanë qenë të njohtuara paraprakisht që do të fillon puna; - Vendosja e 	Global Center DVD LTD export-import, Kumanovë, Komuna e Petrovecit, Kontraktues, inxhinier- mbikëqyrës	Para se të fillohet me aktivitetet e Rindërtimit dhe renovimit	Shpenzimet janë të parapara në buxhetin e kompanisë

		<p>rendit të duhur për komunikacion e aprovuar nga autoritetet kompetente (p.sh. policia e trafikut);</p> <p>- Sheshi i lodrave të fëmijëve dhe mjetet janë të dizajnuara në pajtim me legjislacionin e duhur dhe duke ndjekur praktikat dhe standardet më të mira internacionale të sigurisë..</p>			
	Ndotje e lehtë (foto- ndotje)- Ndikimet mbi biodiversitetin rrethues	- Zgjedhja/ Dizajni i lampave do të minimizon ndotjen e mundshme nga dritat.	Global Center DVD LTD export-import, Kumanovë, Komuna e Petrovecit, Kontraktues, inxhinier- mbikëqyrës	Faza e dizajnit	Shpenzimi është i përfshirë në buxhetin e kompanisë
Faza e rindërtimit dhe renovimit					
- Faza e rindërtimit dhe e renovimit	Ndikime të mundshme negative sociale dhe shëndetsore ndaj punëtorëve, përdoruesve dhe popullatës lokale si rezultat i mosveprimit ndaj masave të sigurisë	<p>- Implementimi i praktikave të mira të ndërtimit gjatë kësaj faze, duke përfshirë:</p> <p>- Sigurimi i shënimit të përpiktë të lokacioneve të projektit me shirite dhe shenja paralajmëruese, nëse duhet të ndërtohet edhe gardh;</p> <p>- Instalimi i sinjaleve limitimin/kufizimin e shpejtësive të automjeteve afër lokacionit të</p>	Kontraktues, inxhinier- mbikëqyrës	Gjatë aktiviteteve të rindërtimit dhe të renovimit	Shpenzimet janë të përfshira në fakturat e kuantiteteve

		<p>proektit;;</p> <ul style="list-style-type: none">- Hyrja e personelit të paaautorizuar në mbrendësi të lokacionit të proektit nuk është e lejuar;- Është i vendosur regjim special i trafikut, i aprovuar nga autoritetet kompetente (Psh, policia trafikore) për automjetet e Kontraktuesit gjatë periudhës së rindërtimit (së bashku me të punësuarit e komunës dhe departamentit policor) dhe instalimi i shenjave që të ketë siguri, rrjedhë e komunikacionit dhe hyrje deri te vendi dhe objektet ;-Vendosja e sinjalizimit vertikal dhe shenjat në fillim të vendndërtimit;-Makinat duhet të voziten vetëm nga personeli i trajnuar dhe me përvojë, me qëllim që të zvogëlohet rreziku i aksidenteve;- Të gjithë të punësuarit duhet të jenë të njohtuar me rreziqet nga zjarri dhe masat për mbrojtje nga zjarri, këto duhet të trajnohen në përdorimin e			
--	--	---	--	--	--

		<p>arapateve të shuarjes, hidranteve dhe mjeteve tjera për shuarje të zjarrit;</p> <ul style="list-style-type: none">- Të punësuarit duhet të jenë të trajnuar, të certifikuar dhe me përvojë për punën që janë duke kryer në pajtim me legjislacionet nacionale profesionale, shëndetsore dhe sigurie ;- Mjetet, makinat dhe shuajtësit e zjarrit gjithmonë duhet të jenë funksionale, që nëse ka nevojë të mundën të përdoren menjëherë dhe me efiksitet;- Në vend duhet të kemi në qasje çanta të ndihmës së parë dhe personel të trajnuar për përdorimin e saj;- Procedurat për situatë emergjente (që përfshijnë derdhje, aksidente etj) janë në qasje në vendndërtim;-Të punësuarit do të kenë të veshur PPE (veshje personale mbrojtëse);- Veshjet mbrojtëse personale të të			
--	--	--	--	--	--

		<p>punësuarve janë në qasje në kuantitete të mjaftueshme dhe veshen/përdoren në çdo kohë;</p> <p>- Sheshi i lodrave të fëmijëve si dhe mjetet për aktivitete zbavitëse janë të ndërtuara në pajtim me legjislacionet nacionale dhe duke ndjekur praksat dhe standardet internacionale më të përsosura të sigurisë;</p>			
Ndikimet në ajr					
